



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.09.2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 30 shtator – 18 tetor.
3. Shqyrtimi i projektrezolutës “Për mbështetjen e fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin European në sektorin ekonomik””.
5. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi European – Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë (në cilësinë e vëzhgueses) në punën e Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007”.
6. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Taulant Balla, Musa Ulqini, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Nikolin Staka, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Edlira Hyseni dhe Kostaq Papa.

Mungon:

Sadri Abazi.

Të ftuar:

Belinda Ikonimi – Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

Majlinda Hafizi – Drejtoreshë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit
në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të komisionit me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.09.2019; shqyrtimi dhe miratimi i kalendarit të Komisionit për Integrimin European për periudhën 30 shtator – 18 tetor; shqyrtimi i projektrezolutës “Për mbështetjen e fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, si dhe shqyrtimi i projektligjeve: “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”” dhe atij “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi European-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë (në cilësinë e vëzhgueses), në punën e Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007”.

E nisim fillimisht me miratimin e procesverbalit.

Ka vërejtje? Kush është dakord?

Miratohet.

Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimin dhe miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 30 shtator-18 tetor. Biem dakord me kalendarin e punës së komisionit?

Miratohet.

Vijojmë me pikat e tjera të rendit të ditës: shqyrtimi i projektrezolutës “Për mbështetjen e fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, shqyrtimi i projektligjeve “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”” dhe atij “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi European – Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë (në cilësinë e vëzhgueses) në punën e Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007”.

Të tjera njoftime do të bëhen në fund të mbledhjes, siç është ai për raportin që ka dërguar Ministria e Brendshme pas kërkesës së Komisionit të Integritetit European.

Pa humbur kohë, fillojmë me shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektrezolutës “Për mbështetjen e fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, që është një nga projektrezolutat më të rëndësishme në kuadër të çeljes së negociatave, pra që presim në samitin e 17-18 tetorit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Përpara në tavolinë ju është shpërndarë projektrezoluta, në të cilën janë integruar disa nga ndryshimet e ardhura; amendamentet e propozuara nga zoti Ditmir Bushati, si dhe një amendament i ardhur nga Grupi Parlamentar Demokrat dhe Grupi Parlamentar i Pavarur.

Duke qenë se këto amendamente kanë ardhur në momentin e fundit të mbledhjes...

(Reagim nga salla)

Është e rëndësishme që ne të biem dakord në parim në lidhje me projektrezolutën, në mënyrë që të mos t’i lëmë të ftuarit tanë të presin më gjatë.

Prandaj kërkoj nga anëtarët e Komisionit për Integrimin Europian të biem dakord në parim për projektrezolutën dhe, pasi të largohen mediet, ne të **shqyrtojmë** pikë për pikë të gjitha amendamentet e propozuara nga deputetët dhe nga grupet parlamentare që përmenda. Kjo projektrezolutë do të shqyrtohet edhe në seancën plenare të radhës të datës 03.10.2019.

(Reagim nga salla)

Biem dakord në parim me projektrezolutën? Ju lutem, tani është momenti për të votuar!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektrezoluta. Shqyrtimin me të gjitha propozimet do ta zhvillojmë pasi të kemi rënë dakord me tekstin e saj.

Faleminderit!

(Reagim nga salla)

Ka ndonjë propozim tjetër në lidhje me këtë çështje? Biem dakord?

Dakord.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Taulant Balla, Musa Ulqini, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Nikolin Staka, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Edlira Hyseni dhe Kostaq Papa.

Mungon:

Sadri Abazi.

Të ftuar:

Belinda Ikonimi – Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

Majlinda Hafizi – Drejtoreshë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Rudina Hajdari – Viojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik””.

Të ftuar kemi dy përfaqësues. Më ndihmoni pak me emrat.

(Reagim nga salla)

Atëherë, kemi zonjën Belinda Ikonomi, zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financat.

Fjala është për ju.

Belinda Ikonomi – Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Prej më se një viti procesi i integritit ka hyrë në një fazë të re dhe të pakthyeshme.

Procesi i parë...

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Procesi i *pre-screening*, i cili tashmë është një proces i pakthyeshëm, ka filluar. Gjatë këtij procesi është duke u analizuar në detaje niveli i përafrimit dhe i zbatimit të legjislacionit për të gjithë kapitujt e *acquis*-së së Bashkimit Europian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është një proces sa politik, ashtu edhe teknik, ndaj suksesi i tyre varet, pa dyshim, nga niveli i përgatitjes së administratës shtetërore.

Duke qenë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë është një nga institucionet që ka peshën më të madhe, si lider i lartë i 13 kapitujve, është parë e nevojshme dhe kemi marrë mbështetjen e qeverisë gjermane për këtë proces, në mënyrë që disa kapituj të caktuar të kenë mbështetje teknike nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, e cila diskutohet edhe sot në parlament. Për këtë arsye, qeveria gjermane është angazhuar të sigurojë financimin e projektit në fjalë në shumën 2 milionë euro dhe për një kohëzgjatje prej tre vjetësh. Projekti do të zbatohet nga GiZ-i.

Në fakt, ne kemi pasur bashkëpunim edhe më parë gjatë viteve 2015-2018 dhe mbështetje nga qeveria gjermane nëpërmjet GiZ-it, kryesisht në hartimin e legjislacionit, të akteve në përputhje me *acquis*-të. Por, tashmë, kalojmë në një fazë të re, ku objektivi kryesor i zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të jetë pikërisht forcimi i kompetencave dhe i aftësive të stafit, të administratës shtetërore për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Ndër komponentët kryesorë, të përcaktuar edhe në këtë marrëveshje, janë pikërisht zhvillimi i kapaciteteve dhe metodologjive. Pra, këtu për të gjitha grupet ndërinstitucionale, të cilat janë ngritur për çdolloj kapitulli, do të jepet mbështetja dhe pajisja me instrumente pune dhe njohuritë e nevojshme për zhvillimin e negociatave.

Një element mjaft i rëndësishëm është parapërgatitja për adresimin e kushteve potenciale për hapjen dhe mbylljen e negociatave për kapituj të caktuar, pra pikërisht për përgatitjen e dokumenteve strategjike, planet e detajuara të veprimit, shoqëruar këto edhe me masa për zhvillimin e kapaciteteve personale për hartimin e tyre.

Një tjetër element i rëndësishëm është përfshirja e shoqërisë civile. Në këtë fushë pritet mbështetje, nëpërmjet këtij programi, për identifikimin e aktorëve të rëndësishëm të shoqërisë civile në fusha të caktuara. Pikërisht, përfshirja e tyre në këtë proces do të lidhet me pjesën e përgatitjeve për bisedimet e anëtarësimit.

Sikurse e përmenda, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kryeson gati 13 kapituj. Deri në këto momente që flasim ne kemi zhvilluar rreth 11 takime shpjeguese për këta kapituj, ku jo vetëm stafi i Ministrisë së Financave, por edhe të gjitha ministritë e tjera kanë marrë pjesë në mënyrë intensive në këto takime, duke identifikuar të gjithë punën që ne kemi përpara për kapitujt.

Ky projekt është shumë i rëndësishëm, pasi, sikurse e përmenda, mbështetja e stafit dhe rritja e ekspertizës së tyre është proces kyç, pasi vetë procesi është shumë teknik dhe kërkon angazhimin e të gjitha administratave. Ndaj edhe ekspertiza e ofruar, pa diskutim, që rrit potencialet.

Faleminderit!

(Diskutime në sallë)

Rudina Hajdari – Ju lutem, mbani pak qetësi!

Faleminderit, zonja Ikonimi!

Vijojmë me pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Ka pyetje lidhur me marrëveshjen?

(Reagim nga salla)

Nuk keni.

Kalojmë te diskutimet ose komentet nga kolegët.

Kush e do fjalën? Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Në fakt, zonja kryetare, kolegë deputetë, kjo është një marrëveshje, e cila rikonfirmon angazhimin e rëndësishëm të Republikës Federale Gjermane në mbështetje të reformave shumëplanëshe që Shqipëria ka ndërmarrë dhe vijon të ndërmarrë.

Dua të shpreh edhe një herë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, mirënjohjen qoftë për qeverinë gjermane, por, në veçanti, dua të përfitoj nga rasti që në këtë mbledhje të parë të Komisionit për Integrimin European, pas votimit në Bundestag të autorizimit që ky i fundit i jep qeverisë federale për fillimin e bisedimeve për anëtarësim, nisur nga fakti se dy të tretat e Bundestagut gjerman u shprehën në favor të fillimit të bisedimeve, të theksoj që kjo është shprehja më kuptimplote e gjithçkaje ka bërë Shqipëria deri tani; është konfirmim i rrugës proeuropiane të Shqipërisë dhe, pa dyshim, është edhe një vlerësim për punën që ne si Kuvend i Shqipërisë kemi bërë në jetësimin e reformave të rëndësishme, ndër të cilat, pa dyshim, do të theksoja që reforma në drejtësi është reforma thelbësore dhe gur i themelit, mbi të cilën është ngritur qoftë vlerësimi pozitiv nga ana e Komisionit European më 29 maj të këtij viti, qoftë edhe vlerësimi nga ana e Bundestagut gjerman në seancën e shkuar të Bundestagut, ku u ritheksua fakti që Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në rrugën e saj europiane.

Ndaj, dua të bashkëndaj me ju në këtë seancë të Komisionit për Integrimin European që, pa dyshim, çështjet e ngritura nga Bundestagu janë detyra shtëpie, për të cilat ne duhet të intensifikojmë punën për plotësimin dhe realizimin e tyre. Qoftë reforma e plotë zgjedhore, qoftë plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën e Lartë, përmbyllja e ngritjes së institucioneve të reja, sikurse Prokuroria Speciale Antikorrupsion apo Byroja Kombëtare e Hetimit, janë të gjitha në rrugë të mbarë.

Unë sot dua të them vetëm një gjë, që populli shqiptar e meriton tërësisht fillimin e bisedimeve. Është ai i pari që ka bërë gjithçka për ta mbështetur këtë proces. Jemi krenarë që jemi vendi, që ka më shumë se 94% të popullsisë, e cila e mbështet procesin e anëtarësimit tonë në Bashkimin European.

Por më lejoni të them që një vlerësim të veçantë meriton edhe qeveria shqiptare, përfaqësuesit e së cilës janë edhe në komision, për gjithçka është bërë në këtë këndvështrim.

Pa dyshim që të gjitha partitë politike duhet të marrin përgjegjësitë e tyre në këtë proces, i cili është një proces ku të gjitha palët kanë detyrime, por kushdo, që u mundua të pengonte reformën në drejtësi, besoj se e ka marrë mesazhin e qartë. Kushdo që u mundua të pengonte zgjedhjet e 30 qershorit, ka marrë një mesazh të qartë, e parë kjo edhe nga raporti paraprak i Komisionit të Venecies apo nga raporti përfundimtar i ODIHR-it për zgjedhjet e 30 qershorit.

Në projektligjin në fjalë, dua thjesht t'i kërkoj qeverisë që të jemi rigorozë në plotësimin e detyrave që burojnë nga procesi.

Qeveria gjermane mbetet donatori kryesor i mbështetjes së reformave në Shqipëri. Kujtoj këtu se janë mbi 1 miliard euro investime gjermane në 27 vjetët e fundit, duke e renditur Gjermaninë në vendin e parë për sa i përket mbështetjes direkte të Shqipërisë, të ekonomisë shqiptare dhe popullit shqiptar.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Edhe unë, në emër të Grupit Parlamentar të Pavarur, dua të shpreh mbështetjen tonë për miratimin e këtij projektligji lidhur me ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Bëhet fjalë për lokomotivën ekonomike dhe politike të Bashkimit European, ndaj jemi shumë mirënjohës për mbështetjen teknike që Gjermania i ofron Shqipërisë në kuadër të zhvillimit të bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin European.

Jam dakord që, tashmë, gjatë javëve dhe muajve në vazhdim, vëmendja duhet të përqendrohet tek adresimi jo vetëm i kushteve, që janë ngritur nga Bundestagu, se, në fund të fundit, këto janë kushtet e nevojshme për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe burojnë, së pari, nga nevojshmëria në vendin tonë sesa nga nevojshmëritë në vendet anëtare, por, ashtu siç tentativat e mëparshme për bllokimin e reformës në drejtësi apo të procesit ligjvënës, legjitimitetit të parlamentit, legjitimitetit të zgjedhjeve të fundit lokale, dështuan. Dua të shpreh vendosmërinë tonë që edhe reforma tjetër madhore, pas reformës në drejtësi, pra, ajo tërësore zgjedhore, nuk do të bllokohet dhe ne do të bllokojmë çdo lloj tentative tjetër nga çfarëdo lloj aktori politik, brenda apo jashtë parlamentit, që tenton ta minimizojë rëndësinë e kësaj reforme kaq të rëndësishme, jo vetëm për anëtarësimin tonë në Bashkimin European, por, mbi të gjitha, për të garantuar të drejtën e votës së lirë dhe të barabartë të çdo qytetari shqiptar dhe një përfaqësim demokratik të vërtetë të vullnetit qytetar në parlament.

Ndaj unë ftoj edhe kolegët e tjerë të komisionit që të kthehemi te projektligji në fjalë, për ta miratuar këtë projektligj, sepse besoj që nuk ka shumë debat për sa i përket një ndihme kaq të vyer dhe kontributit të qeverisë federale gjermane ndaj Shqipërisë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari- Faleminderit, zoti Gjoni!

Dua të komentoj pak për këtë projektligj, i cili, vërtetë është tejet i rëndësishëm për Shqipërinë dhe për procesin në Bashkimin European. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të përgatitur për t'i plotësuar këto kritere, sepse kjo i jep qeverisë shqiptare një përgjegjësi shumë të madhe. Para se të themi se kemi vullnetin për t'i përmbushur kriteret, duhet të jemi të qartë nëse ky do të vijojë të jetë një hendek tjetër për Bashkimin European, për anëtarësimin tonë në Bashkimin European, apo do të plotësohen ashtu siç është udhëzuar nga ky projektligj.

Gjithashtu, më lejoni të përmend faktin se vendimi i Bundestagut ishte një vendim për t'u përshëndetur nga qeveria shqiptare, por edhe nga opozita parlamentare, sepse ne jemi të unifikuar në këtë drejtim dhe nëpërmjet rezolutës që ne kemi propozuar, unë si kryetare e Komisionit të Integritetit bashkë me nënkryetarin e këtij komisioni, inkurajojmë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit European për të hapur fillimin e procesit të anëtarësimit me Bashkimin European.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se kemi akoma vende të tjera, të cilat janë ende skeptike, siç është Holanda, dhe nuk duhet të shpejtojmë në mendimet tona dhe ta bëjmë publikun shqiptar konfuz për atë që çfarë po ndodh. Pra, ne duhet t'i marrim gjërat hap pas hapi, të mos rrëmbehemi dhe të shikojmë me kthjelltësi se çfarë kushtesh na ka vënë Bundestagu dhe qeveria gjermane në lidhje me përparimet që ne duhet të bëjmë bashkërisht, duke marrë parasysh jo vetëm qeverinë, por edhe opozitën, sepse është një përgjegjësi e të gjithëve, edhe e atyre që janë jashtë parlamentit. Ky është një detyrim ndaj qytetarëve shqiptarë, që e duan anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European. Ata po presin që politika shqiptare të gjejë vullnetin e duhur për ta çuar këtë proces përpara, por edhe për të plotësuar të gjitha kushtet që na ka vënë Bashkimi European, apo Bundestagu në rastin konkret. Ne do t'i diskutojmë në parlament të gjitha pikat e kësaj projektrezolute, që janë përmendur në kushtet e Bundestagut, duke përfshirë këtu ngritjen e Gjykatës Kushtetuese, ngritjen e Gjykatës së Lartë dhe të gjitha organeve të drejtësisë brenda vitit 2019. Po ashtu, do të kemi me përparësi reformën zgjedhore, për të cilën është ngritur edhe Komisioni i Reformës Zgjedhore, që ta mbyllim brenda këtij mandati. Ne do të bëjmë të mundur që kjo reformë zgjedhore të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe sa më e denjë për qytetarët shqiptarë.

Nuk dua të zgjatem më shumë, por dua të shpreh votën time pro për miratimin e kësaj marrëveshjeje. A ka komente të tjera?

Kalojmë në votimin e marrëveshjes.

Kush është dakord? Abstenim nuk ka. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Miratohet.

Neni 2.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Miratohet.

Faleminderit shumë!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi European – Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë (në cilësinë e vëzhgueses) në punën e Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007”.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Taulant Balla, Musa Ulqini, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Nikolin Staka, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Edlira Hyseni dhe Kostaq Papa.

Mungon:

Sadri Abazi.

Të ftuar:

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Rudina Hajdari- Të nderuar kolegë,

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi European-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në cilësinë e vëzhguesit në

punën e Agjencisë së Bashkëpunimit European për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së KE-së nr. 168/2007”.

Të ftuar kemi zonjën Fjoralba Caka, zëvendësministre e Drejtësisë, dhe zotin Besmir Beja, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Fjala është për ju.

Fjoralba Caka –Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Propozimi i Ministrisë së Drejtësisë lidhet me një proces, i cili, në fakt, ka filluar që në vitin 2013, kur qeveria shqiptare paraqiti kërkesën për të qenë anëtare, në cilësinë vëzhguese, në Agjencinë për të Drejtat Themelore në Bashkimin European.

Dua të flas shumë shkurt për Agjencinë, pastaj do të flas për interesin që qeveria shqiptare ka për të qenë pjesë e kësaj Agjencie.

Agjencia për të Drejtat Themelore në Bashkimin European është themeluar në vitin 2007, në kuadër të një dokumenti shumë të rëndësishëm që Bashkimi European filloi dhe hartoi, Karta e BE-së për të Drejtat Themelore të Njeriut. Me krijimin e këtij dokumenti dhe me hyrjen e tij në fuqi me Traktatin e Lisbonës ky dokument vendosi një standard të veçantë për të mbrojtur të drejtat themelore në gjirin e Bashkimit European, një standard i ri me disa të drejta shumë inovatore sesa dokumentet e tjera të të drejtave themelore të njeriut, që janë parashikuar në konventat gjerësisht të njohura, si: KEDNJ-ja, Konventa Europiane e të Drejtave Themelore të Njeriut apo Karta e OKB-së.

Kjo Agjenci synon të informojë qoftë institucionet e Bashkimit European, qoftë shtetet anëtare, lidhur me standardet e të drejtave themelore të njeriut, të ofrojë ekspertiza, studime dhe të dhëna krahasuese. Në nenin 28 të Rregullores nr. 168 të vitit 2007, që themelon këtë Agjenci, parashikohet mundësia që edhe ato vende, të cilat kanë statusin e kandidatit, të mund të hyjnë në rolin apo cilësinë e vendit vëzhgues. Nisur nga kjo, ne paraqitëm në vitin 2013 kërkesën për të qenë shtet anëtar dhe, me t’u bërë shtet potencial kandidat, ne fituam mundësinë për të paraqitur kredenciale formale për anëtarësim.

Historiku: më 8 mars të viti 2016 Komisioni European dha pëlqimin; në dhjetor të vitit 2017 Këshilli paraqiti miratimin për aplikimin e Shqipërisë për statusin e vëzhguesit në këtë Agjenci, pasi mori edhe miratimin e parlamentit, dhe pas një miratimi formal nga institucionet e Bashkimit European u mor në 9 dhjetor të vitit 2018 vendimi nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, që përcakton kushtet dhe termat, me të cilat Shqipëria do të bëhet një

shtet anëtar vëzhgues. Ministria e Drejtësisë është menduar si autoriteti i përshtatshëm për të qenë ndërlidhës në këtë marrëveshje dhe, pasi kemi marrë në mënyrë formale dhe zyrtare notat e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, ne filluam me hartimin e këtij projektligji, të cilin e keni sot përpara.

Anëtarësimi i Shqipërisë në këtë Agjenci paraqet interes të veçantë për sa u përket standardeve më të larta të mbrojtjes të të drejtave themelore në BE dhe, siç e thotë edhe vetë rregullorja, anëtarësimi i vendeve kandidate synon pikërisht për të parë standardet që mbron BE-ja lidhur me të drejtat themelore të njeriut dhe, nga ana tjetër, Agjencia merr përsipër të asistojë këto vende, që në përafrimin e legjislacionit kombëtar, me *acquis communautaire*, për sa u përket të drejtave themelore, procedurat të jenë sa më të qarta, rregullat të jenë të qarta dhe procesi të jetë më i thjeshtë. Kjo është parashikuar edhe në këtë marrëveshje. Në këtë kuadër, ne, si Ministri e Drejtësisë, paraqesim para jush projektligjin për të qenë anëtarë pranë Agjencisë me statusin e vëzhguesit.

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë!

Unë kam një pyetje lidhur me këtë projektligj, sepse shikoj që kërkohet nga ju një punë shumë e madhe për ta bërë. A e keni ju kapacitetin për ta bërë të gjithë këtë, duke marrë parasysh se duhet të analizoni dhe të gjeni burimet njerëzore për ta monitoruar të gjithë procesin që buron nga kjo Agjenci? A e keni gati këtë strukturë, apo është një gjë në ndërtim e sipër?

Fjoralba Caka- Vetë marrëveshja, po kështu edhe po të lexojmë vendimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, nuk parashikon ngritjen e një strukture të posaçme për këtë Agjenci. Vendet e tjera, të cilat kanë statusin e vendit kandidat dhe statusin e vendit vëzhgues, që janë vende fqinje të Ballkanit Perëndimor, janë Maqedonia dhe Serbia. Tashmë janë dy vende nga Ballkani Perëndimor, që e kanë marrë statusin e vëzhguesit dhe, kur je me statusin e vëzhguesit, ne jemi anëtarë me këtë status në bord, ne paraqesim kandidaturën, një person të pavarur, për të qenë në bord dhe për të dhënë informacion, por marrëveshja nuk kërkon ngritjen e një strukture të specializuar për të bërë studime. Vetë agjencia, në mënyrën sesi ajo operon, bashkëpunon me organizata të shoqërisë civile, që do të thotë se në momentin që Shqipëria bëhet me status vëzhguesi, atëherë vetë Agjencia mund të bashkëpunojë me organizata të shoqërisë civile në Shqipëri për të marrë informacione, pasi studimet që bën kjo Agjenci janë studime tematike dhe jo studime në bazë vendi. Pra, nuk ka një qasje siç ka komisioni me progresraportet, ku ne duhet ta furnizojmë me material dhe informacion çdo 6 muaj, sepse statusi i Agjencisë është diçka tjetër, i cili bën studime tematike dhe kërkon bashkëpunim nga

shoqëria civile. Në këtë kuadër nuk kërkohet një angazhim i posaçëm i qeverisë shqiptare me struktura informative apo dhënie studimesh zyrtare. Ai do të jetë bashkëpunim i vazhdueshëm.

Rudina Hajdari- Zoti Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni- Faleminderit!

Ne e diskutuam këtë edhe në Komisionin e Jashtëm dhe më lejoni ta ritheksoj edhe këtu në Komisionin e Integritetit Europian. Këtu bëhet fjalë për një kontribut të Shqipërisë, 160 mijë euro për vitin e parë dhe progresivisht në një rritje të lehtë nga viti në vit. Duke qenë se ju jeni institucioni ndërlidhës, që do të merreni me zbatimin e punës me statusin e vëzhguesit pranë kësaj Agjencie, dua të ritheksoj edhe një herë nevojën për një plan pune të qartë nga ana juaj dhe, ndoshta, për një raportim edhe ndaj institucioneve të Kuvendit për sa u përket pritshmërive që ju keni dhe që ne duhet të kemi, si shtet, nga pjesëmarrja me status vëzhguesi pranë kësaj Agjencie. Pra, të mos kthehet në një anëtarësim tjetër të radhës, ku ka kontribut financiar nga kostot e buxhetit të shtetit, ku nuk kemi asnjë plan, por thjesht të dërgojmë dikë atje të shkojë, të ulët, të dëgjojë dhe të shohim rrugës se çfarë mund të dalë nga kjo.

Ajo që unë dua t'ju inkurajoj, edhe në emër të kolegëve të mi të opozitës, është që ju të keni një plan të qartë se çfarë ne, si Shqipëri, duhet të marrim dhe përfitojmë nga kjo Agjenci, me qëllim që të orientojmë edhe nevojshmërinë e shoqërisë civile ose organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri për të bashkëpunuar me këtë Agjenci.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Kalojmë në miratimin e kësaj marrëveshjeje.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA